



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:233923
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876144

KPPP.nr.1736/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit ISKRAMECO d.d, me seli në Savska loka 4, 4000 Kranj, Repubika e Sllovenisë, me NRB: 5045193000, të cilin e përfaqëson avokat Taulant Hodaj me seli në Prishtinë, kundër debitorit Enerco L.L.C, Sh.P.K., me seli në Kodra e Diellit, Objekti 5, Hyrja 11, nr.3, në Prishtinë, Republika e Kosovës, me NRB: 70637820, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.569/23 të datës 29.09.2023 të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 24.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Enerco L.L.C, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përbarimor P.nr.569/23 të datës 29.09.2023 të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, dhe i njëjti urdhër MBETET në fuqi në tërësi.
- II. Detyrohet debitori t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 487.00 Euro, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ISKRAMECO d.d, në bazë të titullit ekzekutiv - aktit noterial – Kontratës për pranimin dhe zotimin e pagesës së borxhit, LRP.nr.15698/2021, numri i referencës 4194/2021 të datës 11.10.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.569/23 të datës 29.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Enerco L.L.C, Sh.P.K., duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh, në emër të detyrimit të papaguar për pjesën e katërt të borxhit, t’ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej 250,000.00 € (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e rënies në vonesë të debitorit, deri në përmbushjen definitive të kërkesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor duke theksuar se pas nënshkrimit të Kontratës për Pranimin dhe zotimin e pagesës së borxhit nr.LRP 15692/2021, ka lindur nevoja për korrigjimin e marrëdhënies kontraktuale mes kreditorit dhe debitorit, respektivisht korrigjim të borxhit të tyre, kështu të njëjtit me datë 26 nëntor 2021 lidhin një marrëveshje të re të quajtur Side Agreement, me të cilën e kanë ndryshuar Kontratën e lartcekur. Më tej ka theksuar se me marrëveshjen e tillë, kreditori dhe debitori janë pajtuar se në rast se do të krijohen shpenzime të kreditorit, debitori do t’i mbulojë ato, ndërsa pagesat e tilla do të zbriten nga borxhi kryesor. Përkundër insistimit të kreditorit për përmbushjen e obligimeve, debitori nuk iu është përgjigjur pozitivisht meqë shuma e kërkuar nga kreditori nuk është e saktë, për shkak se kreditori ka qenë i obliguar në bazë të marrëveshjes, të zbres nga borxhi pagesat që i ka bërë debitori për llogari të kreditorit, respektivisht shumën prej 32,500.00 Euro. Ka shtuar se si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes, ka bërë që dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përmbarues është ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht në këtë mënyrë ka humbur efektin e tij. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.569/2023 i datës 28.09.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se debitori ka përmbushur obligimin e tij monetar për pjesën e parë, të dytë dhe të tretë, ndërsa pjesën e katërt të borxhit në shumën prej 250,000.00 Euro, i njëjti nuk e ka përmbushur brenda afatit dhe kështu të njëjtit i është përcjellur njoftimi përfundimtar përpara anulimit të Kontratës për pranimin dhe zotimin e pagesës së borxhit të datës 11 tetor 2021, dhe fillimin e procedurave përmbarimore në lidhje me mospagesën e këstit të katërt nga kontrata noteriale 15692/2021. Në nenin 5 paragrafi 3 të Kontratës së lartcekur, është paraparë e drejta e kreditorit se në rast se debitori është në vonesë

me pagesën e cilësdo pjesë, ka të drejtë të iniciojë procedurën përmbarimore për të gjithë pjesën e papaguar, që përfshin pricipalin dhe interesin, siç është paraparë në nenin 1.1 të Kontratës. Pretendimi se kreditori dhe debitori kanë lidhur marrëveshje me datë 26.11.2021, përmes së cilës, analizuar fillimisht recitalet e marrëveshjes, në pikën D të saj, është evidente interesi i debitorit që borxhin t'ia paguajë kreditorit në tërësi dhe sa më parë që është e mundur (ndoshta edhe më shpejtë se si është definuar në marrëveshjen për borxhin). Kjo marrëveshje në asnjë moment nuk ka patur e as nuk do të ketë ndikim në efektin juridik të kontratës noteriale, sepse debitori në asnjë moment nuk e ka kontestuar ekzistimin e një marrëdhënie kontraktuale me kreditorin, ekzistimin e borxhit. Kreditori i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.569/2023 i datës 29.09.2023, si dhe të obligohet debitori në shpenzimet e procedurës përmbarimore, shpenzimet e avokatit në lartësi prej 487.00 Euro për përpilimin e propozimit për përmbarim, si dhe shumën prej 487.00 Euro për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti noterial - Kontrata për pranimin dhe zotimin e pagesës së borxhit, LRP.nr.15698/2021, numri i referencës 4194/2021 e datës 11.10.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarimor dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, si dhe është e përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 22 par.1, pika 1.3, 27 dhe 38 të LPP-së dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë.

Sipas nenit 21 të LPP-së, përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.3, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë”*;”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të*

është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë përcaktohet se *“Dokumenti noterial është dokument përmbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm.”*

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor është dorëzuar në ekstrakt të origjinalit dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”.*

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) - Kontratës për pranimin dhe zotimin e pagesës së borxhit, LRP.nr.15698/2021, numri i referencës 4194/2021 të datës 11.10.2021, është përcaktuar që debitori t'ia paguaj kreditorit pagesën e borxhit të mbetur në shumën prej 250,000.00 € (dyqind e pesëdhjetë mijë euro).

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, vlerëson se urdhri për përmbarim i caktuar nga ana e Përmbaruesit Privat mbi bazën e dokumentit noterial është i përmbarueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase dokumenti i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 21, 22 par.1 pika 1.3 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenit 43 të Ligjit për Noterinë. Kjo për faktin se në dokumentin përmbarimor, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, kërkesa është bërë e arritshme për periudhën për të cilën kërkohet detyrimi sipas propozimit për përmbarim, si dhe është përcaktuar që ky dokument-akt noterial të ketë vlerën e dokumentit ekzekutiv (të përmbarueshëm).

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 478.00 Euro, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1736/23, datë 24.06.2024

Gjyqtari,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.